



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

## E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 4.11.2024, me fillim në orën 16:00

**Në mbledhje morën pjesë:** Mirsada Behluli, Arton Brahimi, Elmira Nikçi Rexha, Nenad Miladinovic, Tria Kasumi Berisha, Oktay Kurtesh, Kimeta Shok, Faton Marolli, Adnan Ajeti.

**Në mbledhje morën pjesë edhe:** Përparim Rama – kryetar i komunës, Betim Abdullahu - shef i ZKKK-ës, Klaudia Mula - zyrtare për komunitete, Slavica Stolic - zyrtare për komunitete, Qefsere Veseli - zyrtare e ZKKK-ës, Arianita Beqa Rraci - zyrtare nga UNMIK-u.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit znj. Mirsada Behluli me këtë:

## R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Ftesë për Kryetarin e komunës z. Përparim Rama:
  - a) Bisedë rreth realizimit të projekteve gjatë vitit 2024, si dhe projekteve në vijim,
  - b) Shpenzimi i mjeteve për komunitetet joshumicë nga buxheti i komunës,
  - c) Respektimi i të drejtave të komuniteteve joshumicë.
3. Formimi i Komisionit për hartimin e raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024;
4. Formimi i Komisionit për hartimin e planit të punës të komitetit për vitin 2025;
5. Raporti lidhur me temat aktuale, problemeve, vendimeve nga takimet e fundit të Kuvendit të Kryeqytetit (Elmira Rexha Nikçi dhe Tria Kasumi Berisha);
6. Raport i ZKKK-ës për muajin tetor 2024;
7. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre;
8. Të ndryshme.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

## **Pika e parë**

**Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar**  
Njëzëri u miratua ekstrakti nga mbledhja e kaluar.

## **Pika e dytë**

**Ftesë për Kryetarin e komunës z. Përparim Rama:**

- a) Bisedë rreth realizimit të projekteve gjatë vitit 2024, si dhe projekteve në vijim,
- b) Shpenzimi i mjeteve për komunitetet joshumicë nga buxheti i komunës,
- c) Respektimi i të drejtave të komuniteteve joshumicë.

**Mirsada Behluli** - tha se para se t'ia jap fjalën kryetarit do t'i falënderohesha ku pas takimit tonë që patëm kryetari ka shprehur dëshirë që t'ju dal në ndihmë këtyre familjeve që kanë nevojë për dru zjarri. Pra edhe njëherë në emrin tim personal dhe në emër të të gjithë anëtarëve të Komitetit e falënderoj për dëshirën e shprehur për ndihmë, meqë kjo nuk ishte hera e parë, por sa herë kemi pasur nevojë për diçka të tillë ai na ka përkrahur dhe ndihmuar, kështu që fjalën ia jap kryetarit z. Përparim Rama qysh kishte me na njoftuar lidhur me pikat e lartcekura.

**Kryetari - Përparim Rama** – me të marr fjalën tha se më vjen shumë mirë që ju shoh të gjithëve së bashku si një ekip i madh që kryeni një punë të mrekullueshme për kryeqytet. Me sa e di jam takuar me të gjithë prej juve pasi që më janë fytyrat e njohura, po ashtu më së shpeshti takohem me Betimin i cili më konsulton dhe më jap informata rreth zhvillimeve të punës së ekipit. Ai në vazhdim tha se lidhur me këtë çështje unë diskutoj edhe me Emën sepse e di dhe kam dëshirë, si dhe duhet pasur parasysh për të gjitha problemet që ndodhin në kryeqytet edhe mundësitë për me i zgjidh ato probleme nëpërmjet kryeqytetit. Strategjia jonë e kryeqytetit që nga fillimi ka qenë <Prishtina për të gjithë>, pra secili pjesëtar i komunitetit në Prishtinë, pa marr parasysh a janë shumicë apo pakicë e gjithë strategjia është me e ndier veten të barabartë, të sigurtë dhe të lirë me jetuar dhe me vepruar. Po ashtu e dini që gjithmonë edhe unë si kryetar kam qenë i hapur për çfardo propozimi që kam marr nga komunitetet, faktikisht jam i varur prej këtij grupi apo ekipi për me e ditë se çfarë i duhet komuniteteve. Pra përveç strategjisë së kryeqytetit ku kemi projekte të ndryshme që ju ndihmojmë komuniteteve, ndoshta ato që duhet me i cekur janë edhe si takimi i fundit p.sh që ishte një problem aty me 162 familje që për kryeqytetin është një proces në aspektin burokratik ndoshta mundet me qenë i komplikuar, mirëpo a mundemi me e kryer atë problem shpejt e mirë po edhe këtë e kemi bërë d.m.th e kemi gjetur mënyrën më të mirë dhe më të shpejtë me i ikur burokracisë mos me e zgjatur. Duhet me e pasur parasysh që edhe tash e tutje po them unë jam i hapur edhe dëshira ime e madhe është që çfardo problemi që e kemi me e ditur dhe me zgjedhur menjëherë, sidomos për komunitetin pakicë që ndoshta ndihen të pasigurtë, mirëpo çështja kyçe po dua me e ripërsërit që në kryeqytet nuk duhet me u ndier asnjë person dytësor ndaj tjetrit. Prandaj kërkoj edhe prej ekipit këtu ndihmë nga ju nëse kjo ndodh, po ashtu edhe bashkëpunim po them se ne jemi të hapur unë si kryetar i kryeqytetit mendoj se duhet me i fuqizuar të gjitha komunitetet posaçërisht ato joshumicë me i fuqizuar me e ndier veten jo vetëm që janë pjesë, por edhe janë faktikisht në shumë gjëra edhe prioritare për ndihmën ndaj komuniteteve. Edhe njëherë ju falënderoj nga zemra për këtë punë që po e bëni. Ndërsa sa i përket realizimit të projekteve gjatë vitit 2024, si dhe projekteve në vijim ndoshta Betimi mundet me vazhduar me pikën A, po ashtu edhe shpenzimin e mjeteve për komunitetin joshumicë nga buxheti i komunës.

Dashta me e shfrytëzuar rastin këtu në relacion edhe me komunitet në aspektin e artit, kulturës, sportit, arsimit që me aplikuar në subvencione të kryeqytetit sepse ato janë për të gjithë d.m.th unë nuk kam dëshirë me i ndarë në shumicë dhe joshumicë d.m.th krejt janë prishtinali. Ai mes tjerash tha se unë kam takime të shumta edhe me organizata edhe me organizata joqeveritare që merren me çështjen e komuniteteve edhe i diskutojmë mënyrat se si mundemi me e stimuluar një siguri, një ndjenjë të sigurisë, ku unë gjithmonë

them që në Prishtinë aq sa unë di të gjitha komunitetet e ndjejnë veten të barabartë sa unë e di nëse është ndryshe, atëherë dua me e ditë sepse dua me punuar rreth asaj. Tutje tha se ju kam thënë këtyre organizatave joqeveritare që ne edhe gjatë projekteve p.sh edhe nuk e kisha definuar a është shqiptar, a është serb, rom, egjiptian etj po d.m.th është artist. Pra kështu kur ne e eliminojmë këtë nevojën për me shpreh që a është nevojë për ndryshim, atëherë e kemi arritur qëllimin.

**Slavica Stolic**- shtroi pyetje lidhur me realizimin e projekteve ku ceku çështjen e ujësjellësit në Slivovë. Pastaj ajo tha se pasi kanë kaluar dy vite, për çfarë arsye çdo vit kur bëhet lista për dru zjarri gjithmonë ceket numri në tridhjetë e jo më tepër, ku pastaj ne si zyrë po kemi probleme.

**Betim Abdullahu** – lidhur me çështjen e ujësjellësit në Slivovë tha se në projektin e ujësjellësit e kemi dorëzuar qysh në vitin 2022 në Drejtorinë e Investimeve Kapitale. Unë jam takuar me Krenarin në vitin 2022 -2023 për këtë projekt, është projekt që ka me përfunduar, por ka pasur problem me ujësjellësin për shkak se ujësjellësi është me nivel qendror, ne e dimë se edhe nëpër qytet kemi probleme të ndryshme se ndodh e ndërprejnë ujin e nuk marrin përgjegjësi për rregullim, meqë mund të jenë edhe probleme politike etj. Ai në vazhdim tha se ai projekt është në proces edhe kur e kam dorëzuar, Krenari më ka thënë se nuk do të mund të bëhet për një kohë shumë të shpejtë sepse është një projekt që është mbi 2 kilometra e gjysmë dhe për këtë është i njoftuar edhe Nenadi, mirëpo kjo do të jetë e kryer.

**Slavica Stolic** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se e di se do të kryhet, por ky nuk është uji i qytetit, por ata e kanë ujin natyral, e kanë burimin e ai burim ka nevojë vetëm të lidhet gypi deri tek ato familjet që munden me e shfrytëzuar ujin.

**Nenad Miladinovic** – lidhur me çështjen e ujit tha se ne jemi në fazën e parë ku e kemi grupuar rezervuarin dhe është bërë instalimi i ujit për lagjen e poshtme, pra janë dy lagje, ajo e lartë dhe e poshtme, ku në lagjen e lartë duhet me u vendos gypi për t'u kyçur pasi ky nuk është investim i madh. Meqë me këtë nuk është marrë Drejtoria e Investimeve Kapitale, por është marrë Drejtoria për Shërbime Publike. Kur e kemi prezantuar këtë projekt, zyrtarët e Drejtorisë së Shërbimeve Publike kanë thënë se këtë do ta kryejmë ne pasi që nuk është investim i madh.

**Klaudia Mula** – tha se sa i përket kësaj pjese ne jemi në dijeni për këtë pjesë, si dhe kemi bashkëpunim me drejtoritë që mundemi me marr informacione dhe nuk kemi nevojë me e lodhur kryetarin me këtë pjesë.

**Kryetari** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se mua më duket që është problem i vogël e mundet me u zgjidhur posaçërisht ashtu si po e shpjegoni, e di se ne kemi një projekt të madh të fizibilitetit të të gjitha fshatrave të Gollakut, që e merr parasysh edhe Slivovën, mirëpo nuk ka nevojë me prituri Slivova për krejt këtë fizibilitet nëse mundet me u zgjidhur problemi ashtu lehtë qysh e thatë ju.

Ai në vazhdim tha se mundemi me e dërguar ndonjë përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe të Infrastrukturës me e pa që nëse me një investim të shpejtë mundemi me e rregulluar çështjen menjëherë pa e prituri fizibilitetin për krejt Gollakun.

**Nenad Miladinovic** – tha se unë vij nga Bërnica e Poshtme, ne kemi shumë tema dhe shumë probleme, ku kisha me filluar që nga projektet për vitin 2024, pra projekti për vitin 2024 ka qenë asfaltimi i rrugës në Bërnice të Poshtme, ku punimet kanë filluar në muajin nëntor të vitit 2023 dhe sot e kësaj dite ajo nuk është kryer. E di që ka pasur problem se është dashur të punohet në reshjet atmosferike ku për këtë shkak edhe është zgjatur projekti, të gjitha këto janë bërë, por ende nuk është asfaltuar. Ai në vazhdim tha se është pak problem sepse çdo ditë kalojnë shumë vetura andej, ndërsa gjendja është goxha e rëndë.

**Kryetari** – pyeti se a janë duke punuar tani në rrugë apo jo.

**Nenad Miladinovic** – duke iu përgjigjur kryetarit tha se për momentin nuk është duke u punuar. Tani çështja tjetër është e shtratit të lumit në Bërnice të Poshtme i cili nuk është pastruar ku për shkak të mospastrimit të tij ka pasur dëme të mëdha nga vërshimet ku edhe kryetari ka pasur rastin t'i shoh kur ishte për vizitë Bërnice. Problem tjetër është deponia ilegale të cilin problem qe sa e sa vite e ceku në çdo takim, meqë ne edhe më herët kemi pasur këso probleme, mirëpo këto probleme i kemi zgjidhur përmes Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe në bashkëpunim me policinë, si dhe me organet tjera të komunës.

**Kryetari** – duke u ndërlidhur me këtë pikë tha se për herë të parë në kryeqytet i kemi kontratat me sektorin privat për pika të ndryshme të sektorit privat edhe për licenca të sektorit privat për me i vënë kontejnerë të mëdhenj, si dhe licenca për makinat që i bartin mbeturinat. Do të thotë kushdo që kapet në qytet duke bartur mbeturina pa e pasur licencën do të gjobitet, ndërsa ata që e kanë licencën e dinë se ku duhet me i deponuar. Pra nuk presim ata me i heq prej makinës, por nëse kapen në rrugë kudo që janë do të gjobiten edhe mendoj se kjo do të ndihmojë shumë dhe ka me e bë transformimin. Në fund bëri lutje që nëse shihni ndonjë automjet me mbeturina e fotografoni dhe ia dërgoni edhe policisë edhe inspektionit.

**Elmira Nikçi Rexha** – duke u ndërlidhur në diskutim tha se kryetari e ka kohën e limituar dyzet minuta prej orës edhe dy minuta mundemi me e shfrytëzuar me ndonjë pyetje shumë të shkurtër edhe çka i kemi problematikat e brendshme duhet me i adresuar me kërkesa konkrete tek drejtoritë përkatëse.

**Oktay Kurtesh** – tha se sa i përket kërkesave kemi pasur gjithnjë. Ai në vazhdim shtroi çështjen e çerdheve ku tha se deri para katër viteve kemi pasur vetëm një çerdhe aty tek fakultetet ku tani është hapur edhe tek Ylli nëse nuk gaboj, por është vetëm deri në moshën trivjeçare. Prandaj ai kërkoi që mundësisht të shtyhet deri në moshën pesëvjeçare, meqë aty nuk janë vetëm fëmijët e komunitetit turk, por janë të përzier. 33.46.

#### **Pika e tretë**

**Formimi i Komisionit për hartimin e raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024.**  
Për këtë komision u propozuan: Mirsada Behluli, Elmira Nikçi Rexha, Faton Marolli.

#### **Pika e katërt**

**Formimi i Komisionit për hartimin e planit të punës të komitetit për vitin 2025.**  
Për këtë komision u propozuan: Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic dhe Kimeta Shok.

#### **Pika e pestë**

**Raport lidhur me temat aktuale, problemet vendimet nga takimet e fundit të Kuvendit të Kryeqytetit.**  
Kjo pikë e rendit të ditës është shtyer për muajin dhjetor.

#### **Pika e gjashtë**

**Raport i ZKKK-ës për muajin tetor 2024.**  
Për shkak të moskompletimit të raportit të ZKKK-ës, kjo pikë mbetet për takimin e radhës.

**Pika e shtatë**

**Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre.**

**Kimeta Shok** – sa i përket gjendjes së sigurisë për komunitetin goran nuk kemi kurrfarë problemi, vetëm se shprehi shqetësimin lidhur me ndriçimin e rrugës “Lidhja e Lezhës” ku dhe kanë kërkuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që të interevenojnë pasi po kanë problem me qentë endacakë, mirëpo nuk është ndërmarrë asgjë.

**Triera Kasumi Berisha** – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se çështja e sigurisë do të ishte dashur të diskutohet në institucionet tjera kompetente të cilat janë të thirrura dhe kanë autoritet të plotë në reagimin e çështjeve të tilla. Pra mendoj se duhet që temat dhe pikat e rendit të ditës m’u adresuar në interesa direkt të komuniteteve joshumicë, për shkak se tani po mendoj se po dalim prej kontesteve që janë shumë të rëndësishme për komunitetet joshumicë në këtë rast. Ndërsa sa i përket pikës që jeni dakorduar që unë edhe Ema me fol në Kuvendin komunal, unë mendoj se është shumë më e rrugës me ftuar kryesuesin e Kuvendit komunal z. Fehmi Kupina për shkak se krejt diskutimet dhe problematikat që janë në Kuvendin komunal ne nuk mundemi me i përmbledhur pasi që seancat janë krejt publike dhe të gjitha vendimet publikohen në UEB - faqen e komunës.

**Mirsada Behluli** - propozoi që kjo pikë e rendit të ditës që ka të bëjë me gjendjen e sigurisë së komuniteteve joshumicë të largohet nga rendi i ditës.

**Nenad Miladinovic** – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se OSCE-ja ka thënë që kjo pikë e rendit të ditës të largohet nga rendi i ditës, mirëpo ndoshta nuk është keq që në pika të shkurta sa për informacion të na informojnë se çka po ndodh tek komunitetet joshumicë. Pas ca diskutimesh dhe sugjerimesh nga ana e Komitetit për Komunitete u mor vendim që kjo pikë e rendit të ditës të largohet nga rendi i ditës.

**Pika e shtatë**

**Të ndryshme.**

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Procesmbajtësja  
Lendita Spahija

